

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “SELSEBIL” SH.P.K

Ne Tiranë, sot me date 18/10/2024, ne të nënshkruarit më poshtë:

-**Z.** Eldi SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas shqiptar, i datelindjes 31.01.1988, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: I80131053D.

- **Z.** Elmaz SHERIFI, i biri i Abenit, shtetas shqiptar, i datelindjes 28/ 12/ 1951, lindur ne Salari dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: F11228017K

-**Z.** Enea SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas shqiptar, i datelindjes 07.08.1981, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: I10807056N.

Ne baze e per zbatim te ligjit nr 9901 date 14.04.2008”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “i ndryshuar dhe legjislacionit te Republikës se Shqiperise ne pergjithesi, vendosem si vijon:

### Kreu I

**Emertimi, Selia,objekti,afati i shoqerise**

#### Neni 1

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga akti i themelimit,statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 2

Shoqeria do te emertohet ”**SELSEBIL**”sh.p.k.

#### Neni 3

Selia Qendore e Shoqërisë është në adresen: Rruga Marko Bocari, Pallati 82, shkalla 1, Tirane .

Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, pervec selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

#### Neni 4

Objekti i shoqërisë do të konsistoje ne :

- Veprimtari ndertim objektesh , ndertim veprash rrugore, industriale, turistike, etj. Tregtim, import-export te materialeve ne fushen e ndertimit. Import export dhe prodhim produktesh bujqesore, ushqimore, apo te

**Akt Themelimi i shoqerise ” SELSEBIL “**

çfaredo lloj industrie tjeter. Aktivitete ne fushen e turizmit, agriturizmit. Ndertim dhe Prodhim Energjie nga centrale eolike, solare, hidrike, gjeotermale, apo forma te tjera prodhimi energjie. Tregetim energjie apo produkte e nenprodukte hidrokarburesh si : diesel, bezine, jet oil, etj. Veprimtari ne fushen e sporteve te ndryshme dhe aktiviteteve te tjera argetuese. Veprimtari ne fushen e mjekesise dhe farmaceutikes, permes klinikave, spitaleve apo formave te tjera te trajtimit mjekesor. Veprimtari ne fushen e ristoracionit, bareve, restoranteve, hoteleve. Veprimtari ne fushen e prodhimit dhe perpunimit te produkteve te ndryshme ushqimore apo çfaredo lloj forme tjeter industrie. Veprimtari ne fushen imobiliare, permes hapjes dhe menaxhimit te zyrave imobiliare. Veprimtari ne fushen e finacimit te fushave te ndryshme te ekonomise permes celjes dhe menaxhimit te fondeve te investimit. Veprimtari ne fushen e teknologjive te reja kompjuterike, kibernetikes, si dhe atyre industriale, duke perfshire dhe programimin e software apo cdo lloj risie e shpikje teknologjike ose industriale, dhe patentimin e tyre ne institucionet perkatese nderkombetare, si ne Zvicer apo tjeter.

#### Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar kohe

#### Kreu II

**Kapitali , ortaku , veprimtaria .**

#### Neni 6

##### Kapitali

6.1.Kapitali themeltar I shoqerise eshte **10.000 leke(dhjetmije )** qe perben **3 kuota**, sipas pjesemarrjes se themeluesve ne kapitalin e shoqerise ne perputhje me kontributet si me poshte:

Ne Tiranë,sot me date 16/03/2023 , ne të nënshkruarit më poshtë:

Ortaku Eldi SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 31 / 01 / 1988, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: I80131053D ; zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 1000 (njëmijë) lekë, e barabartë me 10 % (dhjetë përqind) të vlerës së kapitalit

Ortaku Elmaz SHERIFI, i biri i Abenit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 28 / 12 / 1951, lindur ne Salari dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: F11228017K ; zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 500 (pesëqind) lekë, e barabartë me 5 % (pesë përqind) të vlerës së kapitalit.

Ortaku Enea SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 07 / 08 / 1981, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numer personal: I10807056N ; zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 8500 (tetemijëpesqind) lekë, e barabartë me 85 % (tetedhjetepesë përqind) të vlerës së kapitalit

6.2.Kuotat jane të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe Statut. Kuotat e kapitalit shoqërise e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

**Akt Themelimi i shoqerise " SELSEBIL "**

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

6.3.Ortaku mban përgjegjësi të kufizuar në marrëdhëniet juridike –civile me të tretet, përgjegjësi që kufizohet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar prej tij.

#### Neni 7

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

#### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale dhe përfaqësi Brenda dhe jashtë vendit, konform ligjit shqiptar.

### Kreu III

#### Organet e shoqërisë .

#### Neni 9

9.1.Shoqëria është e organizuar në organet e saj drejtuese të cilat janë:

- 1-Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
- 2-Administratori

9.2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me Statutin vendime të cilat janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

9.3.Kompetencat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, janë si më poshtë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### Neni 10

10.1.Organi vendimarrës i shoqërisë , Asambleja e Ortakëve emeron me shumicë të thjeshtë një ose me shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë.

10.2.Afati i emerimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.Emerimi i administratorit prodhon efekte vetëm pas

Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

10.3.Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në cdo kohë, me vendim te marre me shumice te thjeshte nga Asambleja.

10.4. **Administrator i shoqerise emerohet z.** Enea SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 07 / 08 / 1981, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqipërise me numer personal: I10807056N

Emerohet per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje.Administratori mund te shkarkohet me shumice te thjeshte nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

#### Kreu IV

Likujdimi , riorganizimi , baza ligjore .

#### Neni 11

##### **Prishja dhe Likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.;
- c)ne rast se objekti behet i perealizueshem per shkak te mosfunktionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe qe bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregatë
- d)ne rastet e pavlefshmerise se themelimit
- e)ne raste te tjera te parashikuara ne ligj
- f)per cdo shkak tjetër te vendosur nga Asambleja e Ortakeve

#### Neni 12

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

12.1.Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",I ndyshuar.

Akt Themelimi i shoqerise " SELSEBIL "

### Neni 13

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji lex specialis ne Republikën e Shqiperise.

### Neni 14

#### **Zgjidhja e mosmarreshjeve**


Per zgjidhjen e mosmarreshjeve qe kane te bejne me interpretimin e ketij akti themelimi apo ato qe mund te lindin midis ortakëve apo ortakëve dhe te tretteve ,kompetente per keto do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky akt themelimi hartohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe,me vlere te njejte ligjore.


Akti i themelimit pasi u lexua dhe u kuptua nga palet nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire,te plote e te pavesuar.

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**

**z. Eldi SHERIFI**



**z. Enea SHERIFI**



**z. Elmaz SHERIFI**

